



Breaking News:

DVP Durrës – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër



Lajmet

Operacionet

20/02/2023

Shkodër – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Porosia E Fundit”

Shkodër/Finalizohet operacioni policor i koduar “Porosia e fundit”, sekuestrohen sasi kanabisi, fara kanabisi, 1 armë zjarri, 1 armë gjahu (çifte) dhe municion luftarak.

Vihen në pranga 4 shtetas që shpërndanin doza kanabisi, në qytetin e Shkodrës.

Në banesën e njërit prej të arrestuarve, Policia gjeti një pjesë të kanabisit, armët dhe municionin luftarak.

Specialistët e Seksionit për Hetimin e Narkotikëve, në vijim të kontrolleve për kapjen e personave që ushtrojnë veprimtarinë kriminale të shpërndarjes së lëndëve narkotike, bazuar dhe në informacionet e siguruar përmes inteligjencës informative, për një rast të kësaj veprimtarie kriminale, në bashkëpunim me shërbimet e Komisarariatit të Policisë Shkodër, kanë organizuar dhe finalizuar operacionin policor të koduar “Porosia e fundit”.

Në kuadër të këtij operacioni, u arrestuan në flagrancë shtetasit:

B. B., 22 vjeç, F. M., 21 vjeç, E. H., 21 vjeç dhe K. V., 22 vjeç, banues në lagje të ndryshme të qytetit të Shkodrës.

Gjatë operacionit, shërbimet e Patrullës së Përgjithshme kanë ndaluar për kontroll automjetin me të cilin qarkullonin këta shtetas dhe si rezultat i kontrollit gjetën një sasi lënde të dyshuar narkotike cannabis sativa, e cila u sekuestrua në cilësinë e provës materiale.

Në vijim të operacionit, gjatë kontrollit të ushtruar në banesën e shtetasit E. H., shërbimet e Policisë gjetën një tjetër sasi lënde të dyshuar narkotike cannabis sativa, një sasi farash të dyshuara narkotike cannabis sativa, 1 armë zjarri pistoletë, 1 armë gjahu me 2 fishekë në fole, një sasi municioni luftarak dhe 1 shkop bejsbolli, të cilat u sekuestruan në cilësinë e provës materiale, së bashku me 5 aparate celulare.

Nga veprimet hetimore dyshohet se këta shtetas, në bashkëpunim me njëri-tjetrin, shpërndanin doza të lëndës narkotike kanabis, në qytetin e Shkodrës. Viojnë veprimet hetimore për dokumentimin e plotë të veprimtarie kriminale të këtyre shtetasve.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër, për veprime të metejshme.

Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play



Download on the

App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > Arkiva
- > Akademia e Sigurisë
- > Ministria e Brendshme
- > Agjencia e Mbikëqyrjes Policore
- > Interpol
- > Europol
- > Misioni PAMECA V
- > SCPA
- > Projekti Trivalent

◀ DVP Vlorë – Vihen në pranga 2 shtetas, procedohet në gjendje të lirë 1 tjetër.

DVP Durrës – Vihet në pranga 1 shtetas, procedohet penalisht 1 tjetër ▶